

URDHËR
Nr.22, datë 13.6.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 6, DATË 25.11.2005 “PËR SEKUESTRIMIN E ASETEVE TË SHTETASIT JORDANEZ ABDUL LATIF SALEH, I NJOHUR EDHE SI: A) ABDYL LATIF A.A. SALEH, B) ABDYL LATIF SALEH, C) DR. ABD AL-LATIF SALEH, D) ABDYL LATIF A.A. SALEH ABU HUSSEIN, E) ABD AL-LATIF SALIH, F) ABU AMIR”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ligjit nr. 9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr. 9284, datë 30.09.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit” i ndryshuar,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.6, datë 25.11.2005 bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Pika 12 ndryshohet si më poshtë:

“Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për evidentimin e pasurive sipas këtij urdhri dhe transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjekti duke filluar nga data 16.09.2005. RAD dërgohet te drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave brenda 72 orëve nga momenti i konstatimit të transaksioneve ose ekzistencës së këtyre pasurive të përcaktuara në këtë urdhër”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.07.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.05.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave” i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCIVE
Ridvan Bode